VENDIM
Nr.139, datë 3.3.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA E SHËRBIME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të shkronjës "b" të pikës 2 të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Nënndarja "ii" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ii) Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1 dhe karburantit për nevojat e bordeve të kullimit;".

b) Nënndarjet "v" e xiv" shfuqizohen.

c) Nënndarja "ix" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ix) Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike, përveç filtrave të automjeteve;".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha